



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

**PROCESVERBAL**

Datë 02.02.2021, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.173/2014, “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ”
2. Diskutim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i ndryshuar”.

**Të ftuar:**

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes

Bilbil Bitri - Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së

Selami Jenishehri – Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**Marrin pjesë:**

Ermonela Felaj, Antoneta Dhima, Elena Xhina, Elona Gjebrea, Xhemal Qefalia, Edmond Rrushi, Edmond Stojku, Artemisa Malo, Luan Duzha, Lefter Maliqi, Ylli Shehu, Nimet Musaj, Myslim Murrizi, Sadi Vorpsi dhe Spartak Braho.

**Mungojnë:**

Alban Zeneli, Arben Elezi, Anduel Xhindi, Luan Harusha dhe Paulin Sterkaj.

## HAPET MBLEDHJA

**Ermonela Felaj** – Mirëmëngjesi kolegë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare!

Meqenëse kuorumi për fillimin e mbledhjes është i plotë, hapim mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi iniciativën e një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Selami Jenishehri, e cila lidhet me një shtesë në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i ndryshuar”.

Ndërkohë, për pikën e parë të rendit të ditës kemi të ftuar: zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, zotin Ismail Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes, zotin Bilbil Bitri, drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së. Relator do të jetë zoti Qefalia.

Fillojmë me diskutimin nen për nen të ligjit, duke ftuar relatorin të marrë fjalën.

Neni 1 i projektit ndryshon nenin 1 të ligjit aktual.

Zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Që në fillim dua të them se do të ishte mirë që ndryshimet në këtë projektligj të adresohen nga ju dhe, nëse do të kemi ndonjë ndërhyrje, do të ndërhyj edhe unë.

**Ermonela Felaj** – Po e përsëris edhe një herë për kolegët, duke korrigjuar diçka që nuk e thashë drejt, neni 1 i projektligjit ndryshon nenin 4 të ligjit. Neni 4 i ligjit “Për disiplinën e Forcave të Armatosura” bën fjalë për subjektet. Në rrethin e subjekteve të këtij ligji “Për disiplinën e Forcave të Armatosura”, veç ushtarakëve aktivë, kursantëve dhe ushtarakëve në rezervë, por janë në shërbim ushtarak, stërvitje ose shërbim, shtohen edhe studentët. Pra, ky është ndryshimi që propozohet të bëhet. Duhet të kemi parasysh që ne kaluam edhe ligjin tjetër, që lidhet me Forcat e Armatosura, për karrierën brenda FA-ve, dhe u dhamë një gradë të veçantë studentëve, me qëllim që të sigurohet përparimi në karrierë sa më shpejt, që nga momenti që ata hyjnë në Akademinë e Mbrojtjes.

Ka ndonjë vërejtje apo sugjerim për këtë ndryshim të propozuar?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 2 i projektligjit. Ky nen ndërhyt në nenin 7 të ligjit, ku bëhet fjalë për autoritet përgjegjëse. Ndryshimi që propozohet është i tillë që, shefi i Shtabi të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e Komisionit të Lartë Disiplinor, jep masa shumë të rënda disiplinore për nënoficerët dhe ushtarët e Forcave të Armatosura, me përjashtim të atyre që përcaktohen në paragrafin e dytë të germës “c”, të pikës 1 të këtij neni.

Pra, kemi një rreth gradash, të cilat citohen në përmbajtjen e nenit të propozuar. Në rastin kur personat që mbajnë këto grada bëjnë shkelje, që konsiderohen të rënda, masën disiplinore shumë të rëndë e jep shefi i Shtabi të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ky është ndryshimi kryesor që sjell ky nen.

Kemi komente apo vërejtje për këtë nen?

Po, zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Ju e saktësuat tamam, është një shtesë që i është bërë ligjit. Tashmë është futur edhe shefi i Shtabi të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për të drejtuar këto komisione më të larta dhe është një risi në ligj.

Kështu që, siç e thatë edhe ju, është një ndryshim shumë i favorshëm për të gjithë ushtarakët, ata që janë me gradë, nga grada më e ulët deri tek ajo më e larta.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Qefalia!

Ka ndërhyrje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Ju ftoj të votoni. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 3, i cili sjell një ndryshim në nenin 9 të ligjit aktual, që bën fjalë për Komisionin e Lartë Disiplinor. Sipas këtij ndryshimi, ky komision nuk do të ngrihet vetëm në Shtabin e Përgjithshëm, por edhe në komandat e forcave dhe strukturave mbështetëse.

Ka ndonjë ndërhyrje në lidhje me këtë propozim? Besoj se ndryshimi është i qartë. Edhe ky ndryshim vjen konform frymës së përgjithshme të ndryshimeve.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te nenin 4 i projektligjit, që ndryshon nenin 11 të ligjit aktual. Në këtë nen bëhet fjalë për shkelje disiplinore të lehta. Janë shtuar disa shkelje disiplinore të lehta, që, në fakt, në

tabelën që shoqëron diskutimin e këtij projekti do të gjeni një listë të plotë të të gjitha atyre që konsiderohen shkelje disiplinore të lehta. Doni t'i përmend të gjitha shkeljet e lehta, apo jo?

Zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Zonja kryetare, nuk është nevoja. Edhe këtu janë përfshirë të gjitha shkeljet e lehta, përfshirë edhe publikimin e paautorizuar në rrjetet sociale të pamjeve të personave, të efektivëve të Forcave të Armatosura, të armatimit dhe simboleve të tjera, pra është një risi që është bërë pjesë e ligjit, duke përfshirë një gamë më të gjerë të veprave që konsiderohen të lehta.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Ka komente të tjera nga kolegët? Shkelje të reja të përfshira janë: shkrepija e armës nga pakujdesia, e cila nuk shkakton dëme materiale apo lëndime njerëzore, dhe mosmirëmbajtja dhe/ose dëmtimi i armës, municionit, teknikës, pajisjeve ushtarake të Forcave të Armatosura nga pakujdesia, që shkakton humbjen e përkohshme të gatishmërisë teknike të tyre, ndërkohë, edhe shkeljen që citoi relatori.

Këto ishin pjesë e listës, por ka ardhur një lloj ndryshimi në përmbajtjen e tyre: “Publikimi i paautorizuar në rrjetet sociale të pamjeve personale apo të çdo efektivit të Forcave të Armatosura me armatim ushtarak, simbole dhe mjete teknike ushtarake është në shkelje dhe po kështu pranimi i dhuratave ose i ndonjë përfitimi nga vartësit apo personave të tjerë në lidhje me shërbimin ushtarak, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi”.

Ka ndonjë pyetje në lidhje me listën e shkeljeve të lehta?

Në fakt, kam unë një pyetje për shkeljen, që ka lidhje me pranimin e dhuratave apo përfitimin nga vartësit apo personat e tjerë në lidhje me shërbimin ushtarak, nuk e di, do të doja një shpjegim nga zoti Koçi apo nga zoti Shehu, për kufirin ndarës të kësaj shkeljeje me veprën penale të korrupsionit aktiv?

**Ismail Shehu** – Nëse mundem, zonja kryetare, kjo është bërë në përputhje me ligjin. Kemi një ligj kuadër “Për etikën në administratën publike”, që përcakton sa është kufiri maksimal i lejuar për pranimin e dhuratave. Ju kërkohet ndjesë, se për momentin nuk e di saktësisht, por është një vlerë shumë simbolike. Për sa kohë jemi brenda kësaj vlere, le të themi 30 mijë lekë të vjetër, është e pranueshme, është në protokollet zyrtare, kur vjen një palë pritëse apo dikush dhe të bën një dhuratë brenda këtij limiti, që është standard për të gjithë administratën, je në rregull, në qoftë se dhurata pastaj tejkalon këtë limit, që është i përcaktuar me ligj, detyrimisht do të konsiderohet si shkelje minimalisht, pra që vijon një procedurë disiplinore nga Forcat e Armatosura, dhe në qoftë

se ka edhe elemente penalë, pastaj vijohet paralelisht me procedurë për kryerjen e një vepre penale, por që nuk është se konkurrojnë me njëra-tjetrën. Ne e kemi në kuadër të disiplinës. Limiti është ai që përcaktohet me ligj. Pra, ne nuk kemi vendosur limit të ri brenda ligjit për disiplinën.

**Ermonela Felaj** – A mund të shtojmë në përmbajtjen e kësaj pike, në fund të shprehjes “Në kundërshtim me legjislacionin në fuqi “Për etikën e Forcave të Armatosura”, që të jemi korrektë dhe të kemi referencën e qartë? Ligji “Për etikën brenda Forcave të Armatosura” e pranon dhënien e dhuratave ose ndonjë përfitimi, por duhet të jemi brenda asaj që ky ligj nënkupton ose sanksionon.

**Ismail Shehu** – Zonja kryetare, nuk ka ligj specifik “Për etikën në Forcat e Armatosura”, ka në administratën publike dhe kur flasim për administratë publike shtetërore, përfshihen të gjitha organet publike, përfshi edhe Forcat e Armatosura, dhe referenca aty është bërë faktikisht. Në qoftë se e gjykoni të arsyeshme, e bëni edhe referimin të drejtpërdrejtë aty, pa problem.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Ju ftoj të votojmë nenin. Kush është dakord me nenin 4 të projektligjit? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Kalojmë te neni 5 i projektligjit, i cili ndryshon nenin 12 të ligjit aktual, që bën fjalë për shkelje disiplinore të rënda. Edhe këtu kemi një listë të tërë të shkeljeve disiplinore që konsiderohen të rënda. Ka disa shkelje të reja, si më poshtë: mosrespektimi i orarit të punës më shumë se një herë brenda një periudhe njëmuajore; ushtrimi i presionit ndaj vartësve për përfitime personale, kur nuk përbën vepër penale; ngacmim në çdo formë sjelljeje të padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fytes për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Ka edhe disa ndryshime të vogla, disa shkelje janë rikategorizuar, duke u konsideruar të rënda, për shembull: dhënia ose administrimi i dhënies së informacionit me karakter ushtarak, për të cilat ka marrë dizeni gjatë kryerjes së detyrës ose në mënyrë të rastësishme, personave të paautorizuar ose medias kur nuk përbën vepër penale, apo përdorimi i pajisjeve elektronike për regjistrimin ose filmimin e bisedës me eprorët, vartësit dhe kolegët për çfarëdolloj arsyeje pa dizeninë e tyre kur kjo nuk përbën vepër penale.

Nuk po e lexoj deri në fund, por në përgjithësi kjo është ideja.

Disa shkelje që kanë qenë të lehta janë riparë dhe janë konsideruar të rënda dhe në listën e shkeljeve të rënda janë shtuar edhe shkelje të reja të rënda.

Do të doja të kisha një mendim nga ana e relatorit. Jeni dakord?

A mund të kem një shpjegim nga zoti Shehu apo zoti Koçi, për argumentin ku ju shtoni nismën e shkeljeve. Cilës praktikë ligjore apo pune i jeni referuar për të bërë këtë kategorizim?

**Ismail Shehu** – Zonja kryetare, ligji aktual për disiplinën është i vitit 2014, praktikisht janë 7 vjet që operohet me këtë ligj. Kur kemi bërë ndryshimet e para ka qenë edhe eksperiencia e hasur në këto vjet nga komisionet disiplinore, që janë ngritur që nga niveli më i ulët nëpër reparte deri në Shtabin e Përgjithshëm. Është parë si e arsyeshme që disa shkelje të rrikategorizohen se kanë qenë më të rënda ose më të lehta.

Po ashtu, përveç eksperiencës, ne kemi marrë shumë për referencë, jo ligjin se nuk është ligj, një manual të veçantë në Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që e kanë të detajuar deri në ekstrem. Po ta shihni terminologjinë, sidomos tek aspekti i ngacmimit apo i ngacmimi seksual nga eprorët e të tjera, që te ne, për hir të së vërtetës, nuk ka qenë e normuar deri në këtë detaj, të paktën për Forcat e Armatosura, jemi përpjekur të marrim shembujt më të mirë që kanë ushtritë e tjera më të avancuara se ne dhe t'i fusim si pjesë të këtij projektligji. Pra, nuk janë bërë shpikje.

E para, ka qenë eksperiencia që kemi kaluar këta 7 vjet me komisionet disiplinore.

E dyta, u jemi referuar shumë Forcave të Armatosura të SHBA-ve, pra te mënyra se si e shohin ata një proces disiplinor dhe se çfarë kategorizojnë si shkelje të lehtë dhe si shkelje të rëndë. Pavarësisht se kemi impenjuar juristë të Ministrisë së Mbrojtjes, brumi, thelbi dhe debatet janë bërë me Shtabin e Përgjithshëm dhe me vetë forcat, të cilët normalisht kanë më shumë eksperiencë dhe e kanë më qartë se çfarë është një shkelje e rëndë dhe një shkelje e lehtë. Ju kërkohet ndjesë për kohën!

Po marr si shembull regjistrimin me pajisje elektronike të eprorëve, e cila aktualisht është shkelje e rëndë, ndërkohë që, me sugjerimin e vetë pjesës ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Forcave, është kërkuar që të rrikategorizohet si shkelje shumë e rëndë.

Pra, duke u nisur nga koncepti që të marrësh një mjet elektronik telefon, kamera apo ndonjë mjet tjetër dhe të regjistrosësh pa dijeninë e vetë personit dhe të eprorit tënd dhe ta përdorësh për çfarëdoq qëllimi, në kuptimin që japin Forcat e Armatosura është shkelje tepër e rëndë, jo e rëndë.

E para, eksperiencia dhe, e dyta, shembujt e vendeve të tjera, janë marrë si bazë për hartimin e këtyre dispozitave dhe janë bërë ndryshimet përkatëse, duke shtuar apo hequr dispozita konkrete në këtë ligj.

**Ermonela Felaj** – Ju falënderoj për shpjegimin!

Meqenëse u hap kjo temë, këtu kemi një të dhënë të përafërt rreth procesit të disiplinimit brenda Forcave të Armatosura. Sa procese të tilla mund të ndodhin këtë vit? Për shembull, për vitin që sapo mbyllëm apo për vitin 2019, sa procese të tilla kanë ndodhur brenda Forcave të Armatosura dhe si rezulton bilanci i masave disiplinore, në favor të të cilave kemi masa të lehta, masa të rënda apo shumë të rënda?

**Ismail Shehu** – Nuk di t'ju jap një shifër konkrete, por në momentin që do të futet në linjë edhe kolonel Bitri, i cili mund të na japë të dhëna më të sakta sa i takon kësaj pjese, pasi është një pjesë që mbulohet nga pjesa ushtarake dhe jo nga pjesa civile e ministrisë.

Me aq sa unë di masat shumë të rënda janë më të rralla, për shkak se shkeljet janë shumë të rënda dhe rrallë ndodh të ketë gjëra të tilla, edhe pse ka pasur, por pjesa dërrmuese hyjnë te shkeljet e lehta.

Për momentin nuk kam numra konkretë, por ndoshta kur të flasë kolonel Bitri mund të t'ju japë të dhëna më të sakta. Është mëse normale që masat të jepen në mënyrë masive, sepse nuk ka nevojë për komisione disiplinore. Në mënyrën se si është konceptuar ky ligj është edhe fakti që masat e lehta jepen nga vetë komandanti, sepse nëse ti je epror dhe nuk ke mundësi të japësh thjesht masa kur ka shkelje të lehta, atëherë të bie autoriteti dhe gjithçka tjetër. Sa u takon shkeljeve të rënda, që janë edhe më të rralla, gjejnë goxha praktikë të paktën këto 7 vjet, ndërsa masat e rënda disiplinore, të cilat shkojnë deri në lirim nga Forcat e Armatosura janë goxha më të rralla, por ka pasur plot raste të tilla. Për momentin nuk është vendi për t'u përmendur, pasi lidhen me persona konkretë, por ka pasur edhe masa shumë të rënda deri në ekstreme, që është lirimi nga Forcat e Armatosura.

**Ermonela Felaj** – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Dua t'ju them që në rikualifikimin e shkeljeve, sigurisht që është pasur parasysh jo vetëm përvoja në Forcat tona të Armatosura, por edhe përvoja e vendeve të tjera, kështu që nuk besoj se duhet t'i referohemi patjetër numrit të shkeljeve, sipas këtij rikategorizimi. E nevojshme është që të llogariten pasojat, pra pasojat që mund të shkaktoj një shkelje e lehtë, e

rëndë apo shumë e rëndë e disiplinës. Nga ana tjetër, duke iu referuar neneve që kaluam më parë më duhet t'ju them se ka ndodhur edhe një proces decentralizimi në dhënien e masave dhe kjo është parë si diçka shumë e rëndësishme për ta rritur disiplinën në Forcat e Armatosura.

Imagjini që më parë do të duhej të shkoje te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe të ngrihej komisioni për të dhënë një masë disiplinore, ndërsa tani atë e jep komanda e strukturës përkatëse ku ndodh dhe ku supozohet se mund të ndodhë një shkelje, pavarësisht se është e lehtë, e rëndë apo shumë e rëndë. Pra, është mjaft e rëndësishme që ne t'i llogarisim këto dy gjëra, pasojat dhe që kemi një proces decentralizimi, pasi këto do ta rrisnin shumë disiplinën në Forcat tona të Armatosura.

Urojmë që të mos ndodhë asnjë lloj shkeljeje, por nga ana tjetër besoj se nuk është e udhës që ne t'ju komunikojmë këtu numrin e masave disiplinore që janë dhënë qoftë edhe për vitin e kaluar.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Gjithsesi, nuk besoj se dhënia e këtij informacioni është i klasifikuar, aq më tepër që edhe po të ishte i klasifikuar Komisioni i Sigurisë Kombëtare i përmbush të gjitha kriteret për t'u njohur me informacione të klasifikuara. Ideja ishte për të kuptuar më mirë justifikimin që ju vetë na e dhatë, duke u nisur edhe nga praktika e zbatimit të ligjit 7-vjeçar, por edhe nga manuali i Shteteve të Bashkuara për disiplinën në forca të ngjashme, kështu që marrja e informacionit këtu konsistonte dhe ky qëllimi i tij.

A ka pyetje të tjera?

Nuk ka.

Kalojmë në miratimin e nenit 5 të projektligjit.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 6 të projektligjit, i cili ndryshon nenin 13. Ky nen bën fjalë për shkeljet disiplinore shumë të rënda. Edhe në këtë rast lista është përditësuar, duke shtuar shkelje të reja dhe duke ndryshuar në përmbajtje disa prej shkeljeve aktuale.

Shkelje të reja përcaktohen (natyrisht këto janë shkelje të reja shumë të rënda):

“1. Ngacimet seksuale në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesë për favore seksuale dhe sjellja të tjera verbale apo fizike të një natyre seksuale të kryera nga eprori ndaj



varësitet ose ndaj ushtarake me gradë më të ulët gjatë ose jashtë orarit të punës kur nuk përbën vepër penale.

2. Organizimi i lojërave të fatit në ambientet ushtarake me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale.

3. Ushtrimi i dhunës fizike të paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune, sjellja fyese apo kërcënuese ndaj një personi tjetër kur ajo ushtrohet nga oficerët aktivë me grada të larta ose madhorët e Forcave të Armatosura ose kur kryhet ndaj eprorit të drejtpërdrejtë në rastet kur nuk bëhen kallëzim nga i dëmtuari.

4. Refuzimi i zbatimit të urdhrit apo i një vendimi të ligjshëm të dhënë nga eprori.

5. Mosmarrja e masave të duhura të organizimit dhe të sigurisë nga drejtuesit e njësive dhe të reparteve të FA-së kur kjo ka sjellë pasoja të rënda materiale.”

Këto janë disa nga shkeljet e reja.

A kanë kolegët pyetje apo ndërhyrje?

Zoti Qefalia, e ka kërkuar fjalën.

**Xhemal Qefalia** – Zonja kryetare,

Mendoj se duhet evidentuar vendosja e një kriteri ndalues sa i përket Forcave të Armatosura, e cila ka të bëjë me pjesëmarrjen në aktivitete të organizatave politike fetare jofitimprurëse. Meqë në komision ndodhen edhe deputetë të opozitës, ashtu siç ne i kemi konsideruar, Forcat e Armatosura janë forca, të cilat do të jenë jashtë indikacionit politik dhe për këtë arsye mendoj se janë dhënë edhe masa shtrënguese në këtë nen, duke i konsideruar si masa shumë të rënda.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Në fakt, ka qenë e konsideruar shkelje disiplinore shumë e rënda mbështetja e fushatës së një partie, e një organizate politike, e një anëtari të një partie politike, e një kandidati të pavarur, duke marrë pjesë ose kontribuar fizikisht dhe financiarisht. Kjo gërmë e nenit 13 të ligjit aktual është ruajtur po njësoj edhe në nenin 6 të projektligjit.

Po kështu, edhe germa “b” në të cilën thuhet: “Ndihma të tjera ose pjesëmarrja në aktivitetet e organizatave politike fetare ose jofitimprurëse gjatë orarit të punës, në vendin e punës ose në mjetet ushtarake, si dhe në rastet kur mban uniformë ushtarake ose shenja të saj”, është ruajtur e njëjta gërmë.

A ka kolegët pyetje të tjera përveç kësaj ndërhyrjeje?

Po, zonja Xhina.

**Elena Xhina** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, gjatë leximit tuaj sa u takon veprave që mund të përbënin masë disiplinore më shumë ma vranë veshin ngacmimet seksuale në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesa për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale apo fizike të natyrës seksuale të kryera nga eprori kur nuk përbëjnë vepër penale.

Unë nuk di ndonjë rast që këto nuk përbëjnë vepër penale, sepse nëse kemi të bëjmë me ngacmim seksual ato gjithmonë përbëjnë vepër penale. Nuk e di se çfarë kanë dashur të kenë parasysh me këtë?

Po ashtu, më vrau veshin edhe diçka tjetër, kur nuk përbëjnë vepër penale? Ata që i kanë hartuar, a janë konsultuar me Kodin Penal që këto nuk përbëjnë vepër penale, sepse unë e di që në çdo rast këto përbëjnë vepër penale?

Ato mund të jenë vepra të tjera, të cilat kur përsëriten për herë të dytë mund t'i quajmë vepër penale, por për herën e parë mund të merret vetëm masë disiplinore.

Pyetja që kam është, kur ngacmimet seksuale nuk përbëjnë vepër penale?

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Zoti Shehu, fjala për ju.

**Ismail Shehu** – Për t'iu përgjigjur pyetjes së zonjës Xhina, më duhet t'i them që patjetër jemi konsultuar. Çdo dispozitë që shihni te ligji i disiplinës, i cili përfundon duke thënë: kur nuk përbën më vepër penale, të jeni të bindur se Kodi Penal është marrë *mot a mot* dhe dispozita është hartuar, duke pasur parasysh Kodin.

Në moment mund t'ju gjej edhe dispozitën konkrete të Kodit Penal për ngacmimin seksual, por bëhet fjalë kur ka ngacmime seksuale të një natyre të tillë, i cili nuk plotëson elementet objektive dhe subjektive, por nuk po i hyj analizës së një dispozite të një veprë penale. Pra, kur nuk plotëson elementet për të qenë vepër e mirëfilltë, e pastër e ngacmimit seksual vetëm në ato raste ku ne nuk kemi mundësi të bëjmë kallëzim, sepse nuk janë konsumuar ato elemente që kërkon Kodi si të domosdoshme, do të procedojmë me një procedurë disiplinore, ngacmim seksual, e cila në vetvete kur bëhet nga eprori ndaj vartësi apo kur bëhen nga persona me gradë të lartë ndaj atyre me gradë më të ulët shkon deri në lirim, deri në masën ekstreme ku ti largohesh nga Forcat e Armatosura dhe nuk përfiton as suplement, as pagesë kalimtare, asgjë.

Të gjitha këto janë konsultuar dhe këtu nuk ka asnjë pikë që të bjerë ndesh me Kodin Penal.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Zonja Xhina, fjala për ju.

**Elena Xhina** – Vazhdoj të insistoj tek ajo që thashë, pasi Forcat e Armatosura nuk mund të jenë prokurori për të dërguar elementet e anës objektive apo subjektive që kryhen, kështu që jam kundër kësaj gjëje.

Po shoh çështjen tjetër, organizimi i lojërave të fatit në ambientet ushtarake me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale. Kjo është drejtpërdrejt vepër penale, sepse kur vihet edhe qëllimi që është përfitimi nuk e di se çfarë mase disiplinore mund të jepet. Masë disiplinore mund të jepet patjetër, por njëkohësisht kjo duhet të referohet edhe në prokurori si vepër penale.

Po kaloj te çështja tjetër, ushtrimi i dhunës së paligjshme ose tentativa për ushtrim dhune. Ne këtu i japim edhe paligjshmëri veprimit dhe nuk e referojmë në prokurori. Për mua këto ndryshime më duken pa kuptim, sepse jemi brenda kuadrit të veprave penal. Jam shumë dakord që të merren masa administrative, por njëkohësisht duhet të referohen edhe rastet kur nuk përbëjnë vepër penale dhe ne të japin vendimin që përbën ose jo vepër penale për sa kohë aty mund të ketë element të veprës penale.

Ky është mendimi që kisha.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Për sqarim më duhet t'ju them se këto nene nuk përjashtojnë në mënyrë absolute iniciativën për të bërë kallëzim penal për rastet, qoftë për ngacmim seksual apo qoftë për ndonjë shkelje tjetër që përmenden te neni që përcakton shkeljet shumë të rënda të disiplinës. Bëhet fjalë për ato raste kur ka shkelje të tilla, të cilat nuk përbëjnë vepër penale.

Nuk duhet të harrojmë që ne kemi Polici Ushtarake, e cila ka njerëz të kualifikuar për të përcaktuar të paktën në procesin e kallëzimit, nëse një akt përbën vepër penale ose jo, si dhe duhet kallëzuar ose jo në prokurori. Nga ana tjetër nuk duhet të harrojmë që në çdo rast i dëmtuari apo e dëmtuara e kanë të plotë lirinë për të bërë kallëzim për ndjekje penale.

Ky nen përcakton ato raste ku shkalla e veprës nuk është e tillë që të përbëjë vepër penale.

E para, ne nuk e përjashtojmë këtë, sepse varet gjithmonë nga dimensionin, nëse ngacmimi seksual është diçka e natyrës verbale dhe kjo identifikohet, atëherë quhet shkelje shumë e rëndë e disiplinës, edhe sikur të mos ketë ndodhur diçka në vijueshmëri që të përbëjë një vepër penale të

mirëfilltë. Ky ligj e quan shkelje të rëndë të disiplinës dhe masa që do të merret në këtë rast do të jetë shumë e rëndë për ushtarakun.

Ky nen në këtë ligj është diçka që e përforcon qëndrimin tonë ndaj veprave të tilla të supozuara që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së Forcave të Armatosura dhe nuk e përjashton kurrësi kallëzimin e veprës së mundshme penale.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Koçi!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Nuk ka.

Jemi përballë dy rasteve të propozuara për t’u parashikuar si shkelje të rënda në ligjin për disiplinën në Forcat e Armatosura, por që ka dyshime të forta, sepse ruaj të njëjtin gjykim si kolegja Xhina.

Në vitin 2013 në Kodin Penal kemi shtuar nenin 108/a “Ngacmimi seksual”. Ne nuk penalizojmë thjesht kryerjen e marrëdhënies seksuale, duke shpërdoruar detyrën, por edhe ngacmimi seksual në vetvete është diçka e dënueshme nga legjislacioni penal.

Konkretisht: “Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale që cenojnë dinjitetin e një personi në çdo mjet ose formë, pra verbalisht ose fizikisht (siç përdoret në shprehjen që ju keni propozuar) duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet”.

Në legjislacion, që është një hierarki më e lartë sesa ky që na propozohet, e parashikon këtë lloj sjelljeje si veprë penale dhe që nga ky moment ne nuk kemi çfarë të diskutojmë, sepse nuk mund ta konsiderojmë këtë shkelje të rëndë disiplinore, sepse kjo është veprë penale qartësisht.

Sikundër organizimi i lojërave të fatit në ambientet ushtarake me qëllim përfitimin e vlerave monetare ose materiale, ku edhe kjo është e dënueshme nga legjislacioni penal nuk mund të ketë një diskrecion me ndonjë ligj tjetër.

Do ta ftoj zotin Koçi dhe zotin Shehu që ta rishihnin pjesën e shkeljeve të rënda, kështu që këtë nen nuk po e kalojmë sot për miratim nga ana e komisionit, por do të vazhdojmë me nenet e tjera të ligjit.

**Ismail Shehu** – Nëse mundem zonja kryetare?

Kjo dispozitë që po diskutojmë sot aktualisht është në ligjin e disiplinës, pra nuk është risi në këtë ligj, ku ngacmimet seksuale janë sanksionuar si shkelje e rëndë, si dhe është kaluar që kur

është miratuar ligji i parë. Ajo që ne kemi shtuar është fakti që, nëse bëhet nga eprori ndaj vartësit apo nëse bëhet nga një ushtarak me gradë më të lartë ndaj një ushtaraku me gradë më të ulët do të kategorizohet si shkelje shumë e rëndë, pra kalon nga shkelje e rëndë në shumë të rëndë...

**Ermonela Felaj** – Zoti Shehu, e kam përpara ligjin dhe kjo nuk është në nenin 13, sepse kjo është shkelje e re.

Në relacionin që shoqëron projektligjin e keni vënë shprehimisht: shkelje të reja janë 1, 2, 3, 4 dhe 5. Unë kam tabelën, ligjin aktual së bashku me ndryshimet që propozoni dhe kjo nuk ka qenë, është e re. Edhe nëse ka qenë ky nuk është argument që sot që ne po e diskutojmë meqë ka qenë duhet të qëndrojë, sepse bie në kundërshtim me ligjin penal. Në ligjin penal qartësisht ngacmimin seksual parashikohet si vepër penale.

**Ismail Shehu** – Kjo është me kërkesë, zonja kryetare, sepse ne ju ulim garancinë dhe mbrojtjen ushtarakëve në Forcat e Armatosura. Nuk kemi ne...

**Ermonela Felaj** - Ushtaraku që kryen vepër penale del jashtë Forcave të Armatosura në rast se ka kryer vepër penale.

**Ismail Shehu** - Po nëse nuk ka ankim, si veprojmë, ne, zonja kryetare, sepse janë raste të përditshmërisë?

**Ermonela Felaj**- Mos hyni në çështje të procedurës.

**Ismail Shehu** – Do të hyjmë, sepse ka ngacmim, ka frikë dhe nuk ankohet.

**Ermonela Felaj** -Po nëse hyn në çështje të procedurës, unë kam dyshimin se kjo nuk është vepër penale që ndiqet me ankim, është vepër penale që ndiqet kryesisht.

**Ismail Shehu** - Ngacmimi po, jo dhuna seksuale, ngacmimi është me ankim. Edhe ne t'i japim mundësi pastaj, duke pasur një ambient që një ushtarake femër, po marr një rast, si shembull...

**Ermonela Felaj** – Kolegë, që të mos ngecim diskutimin, ju ftoj të shikojmë nenin përkatës në Kodin e Procedurës Penale, por ju siguroj që nuk është vepër penale. Edhe sikur të jetë, kjo nuk ka lidhje fare, sepse është vepër penale. Kaq e thjeshtë është historia.

**Ismail Shehu** - Po ulim garancitë, zonja kryetare, po heqim një gjë që është aktualisht nga ligji dhe po e fshijmë fare. E kemi aktualisht. Neni 12, shkronja “n” e ligjit aktual e ka mot a mot, zonja kryetare, sepse kjo është çështje fakti.

Neni 12, shkronja “n”, thotë: “Ngacmimet seksuale në formën e orvatjes së padëshiruar seksuale, kërkesa për favore seksuale dhe sjellje të tjera verbale ose fizike të një natyre seksuale,

të kryera gjatë ose jashtë orarit të punës”, është aktualisht. Duke e hequr, ulim garancitë që tashmë i kemi sidomos për ushtarakët e seksit femër te Forcat e Armatosura. Pra, nga një dispozitë, që e kemi, ne po e heqim. Unë nuk e shoh të arsyeshme, sepse ne japim garanci ekstra për ushtarakët tonë që, në rast se nuk bëjnë dot ankim për shumë arsye: të presionit, të frikës ose të tjera, të paktën në aspektin disiplinor të kemi mundësi ta ndjekim deri në lirimin e ushtarakut që ka kryer një ngacmim të tillë.

Një ushtarake femër me gradë më të ulët mund të ketë presion, mund të ketë frikë, mund të ketë shumë arsye për të mos bërë ankim, por ne duke e hequr një gjë, që e kanë sot, ulim garancitë për këtë kategori ushtarakësh. Qëllimi ka qenë që të japim garanci ekstra për këtë kategori ushtarakësh, nuk është se kemi bërë diçka të re. E kemi aktualisht, por e kemi shkelje të rëndë, dhe japim masa të rënda, orë shtesë, e të tjerë. Ne po themi se kjo gjë që po bëjmë, ngacmimi seksual, sidomos kur është ndaj femrave, është ekstremisht e rëndë dhe kjo vjen nga praktika. Duke qenë ekstremisht e rëndë, nëse ti je epror dhe ngacmon vartësen tende seksualisht, ti je për të ikur në shtëpi, sepse nuk mund të qëndrosh më në atë vend pune. Pra, ne po rikatégorizojmë një shkelje të rëndë, që është aktualisht, po e çojmë te shumë e rënda, sepse në 7 vjet eksperiencë kemi gjykuar se çështja e ngacmimit seksual është me të vërtetë çështje shumë delikate dhe duhet marrë me seriozitetin maksimal. Nuk mund të vazhdojë të rrijë tek e rënda dhe me logjikë, me arsyetim, qoftë nga pjesa civile e ministrisë, edhe nga pjesa ushtarake, që i ndjek këto raste është gjykuar që kjo duhet rikatëgorizuar si shumë e rëndë, pra duke i dhënë më shumë garanci. Nëse e heqim fare nga shumë e rënda edhe atë minimum garancie që e kemi, e zhdukim fare nga ligji. Kjo ka qenë e gjithë ideja.

**Ermonela Felaj** – Zonja Xhina.

**Elena Xhina** - Faleminderit!

Dëgjova shprehjen: “Nëse bën një ngacmim seksual duhet të ikë në shtëpi”, jo nuk duhet të ikë në shtëpi, duhet të shkojë në prokurori, aq më tepër kur ngacmimi seksual vjen për shkak të marrëdhënieve të punës, nuk besoj se është me ankim të palës së dëmtuar, sepse jemi në ambientet e punës, për shkak të marrëdhënieve të varësisë. Duke qenë se kemi këtë lloj debati, propozoj që ta shtyjmë këtë, ta lëmë të hapur këtë dispozitë për ta parë me qetësi ne, por edhe pjesa tjetër që ka propozuar ndryshimin.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Po, faleminderit!

Zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Atëherë, bëhet fjalë për një ashpërsim të reagimit me masë disiplinore ndaj një rasti shumë të qartë kur ka, po themi, ngacmim seksual dhe nuk përbën vepër penale.

Ju e lexuat qartazi te Kodi i Procedurës Penale se kur ngacmimi seksual përbën vepër penale. Pra, nëse ka një ngacmim seksual, por që nuk është i kualifikuar sipas Kodit të Procedurës Penale, atëherë merret masë disiplinore dhe në themi jo më shkelje e rëndë, por shkelje shumë e rëndë e disiplinës. Ne po e ashpërsojmë ligjin, nuk po e favorizojmë atë që tenton të bëjë ngacmim seksual dhe të përfitojë seksualisht për shkak të pozitës në gradë ose pozitë komanduese në strukturën ushtarake. Pra, jemi duke ashpërsuar ligjin, jo duke e zbutur. Ky është një nga nenet themelore të ashpërsimit të këtij ligji, ky është standard ndërkombëtar, nuk është standard vetëm yni. Mos e ngatërroni, sepse ka një keqkuptim, nuk ka lidhje me përjashtimin nga kallëzimi penal dhe nga ndëshkimi si vepër penale, absolutisht jo. Bëhet fjalë për masat që duhet të marrë struktura ushtarake në rastet kur ka ngacmime të tilla seksuale, që nuk përbëjnë vepër penale, sepse jo çdo ngacmim seksual është automatikisht vepër penale, pasi varet nga shkalla, nga mënyra e të tjera. Pra, ne po flasim për atë pjesë, për atë dukuri, e cila nuk përbën automatikisht vepër penale. Jo se në ushtri ose në shtetin tonë nuk ka vullnet për ta ndëshkuar dhe kallëzuar çdo dukuri të tillë edhe si vepër penale. Ne po flasim qartë: kur ndodh një gjë e tillë dhe nuk përbën vepër penale, atëherë kjo quhet shkelje e rëndë, shumë e rëndë discipline. Pra, jemi duke ashpërsuar ligjin, jo duke e zbutur. Mos e ngatërroni me shanset, mundësinë dhe vullnetin për t'i ndëshkuar penalisht të gjithë ata ose ato që guxojnë për të ndërmarrë akte të tilla të ngacmimit seksual. Kur nuk përbëjnë vepër penale, atëherë reagohet nëpërmjet këtij ligji. Nëse përbën vepër penale, hyn në lojë një tjetër ligj, Kodi i Procedurës Penale, kudo që të ndodhë, në ushtri, në polici, në çdolloj marrëdhënie të punës, madje edhe në kompani private. Ne po flasim për rrethana ose për një shkallë të tillë, që nuk përbën vepër penale, atëherë ndërhyjmë me ashpërsi nëpërmjet këtij ligji.

E theksoj, së pari, është standard ndërkombëtar, nuk është shpikje jona kjo. Pra, po e kalojmë nga një kategori, që quhet shkelje e rëndë, në një kategori, që quhet shkelje shumë e rëndë e disiplinës dhe do të doja duartrokitej nga të gjithë ata që kanë mundësinë për ta votuar këtë nen. Mos u keqkuptoni me Kodin e Procedurës Penale, absolutisht, është një gjë krejt tjetër, nuk e përjashton ndëshkimin.

**Ermonela Felaj** – A ka pyetje?

Atëherë, nenin 6 nuk do ta kalojmë në votim gjatë ditës së sotme, sepse ky nen ka nevojë për t'u riparë qoftë nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, qoftë edhe nga ana e të gjithë kolegëve të Komisionit të Sigurisë, që nuk kanë *background*-in e juristit, në raport me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Qartësisht Kodi Penal "Ngacmimet seksuale" i konsideron vepër penale. Këtu nuk është për të ulur standardin, por për të ruajtur një standard, që është vendosur në vitin 2013 dhe që me gjasë nuk është kuptuar drejt. Mbrojtja penale është mbrojtja më e mirë që mund t'i garantohet çdo viktime nga ngacmimi seksual, është mbrojtja maksimale që mund të ketë.

Kalojmë te neni 7, i cili bën fjalë për masat disiplinore.

Janë bërë disa shtesa dhe ndryshime, në fakt, me këtë nen në nenin 14 të ligjit aktual për masat disiplinore.

Zoti Qefalia, keni fjalën.

**Xhemal Qefalia** - Edhe në këtë nen janë bërë disa ndërhyrje, të cilat japin në mënyrë të përshkallëzuar dhënien e masave disiplinore. Pika 3 e këtij neni ndryshohet, por, meqë kolegët e kanë përpara, nuk po ndalemi në mënyrë të detajuar. Elementi i ri që është futur dhe duhet mbajtur në konsideratë është ulja në gradë për një vit për shkeljen që kanë bërë, për të cilën do të doja një koment nga propozuesit e ligjit, duke pasur në konsideratë që grada është diçka e fituar dhe nuk e di cili është motivi që i ka detyruar ligjvënësin ta propozojnë.

**Ermonela Felaj** – Po, zoti Shehu.

**Ismail Shehu** - Ne i jemi referuar Kodit Penal, këtë e thashë që në krye të herës. Ideja është që ne t'i japim mundësi zgjedhjeje autoritetit vendimmarrës, pra atij që do të japë masën, që të ketë mundësi zgjedhjeje, sepse një shkelje ndryshon nga një shkelje tjetër, pavarësisht se janë një kategori. Për më tepër ligji parashikon rrethana lehtësuese dhe rënduese, që do të thotë se mund të jenë dy raste për t'i vënë shkelje, por për shkak të rrethanave mund të penalizohen ndryshe, duke shtuar gamën e shkeljeve, i japim mundësi vendimmarrësit që të japë një masë të drejtë proporcionale. Ulja në gradë nuk është permanente, pra nuk është diçka që e ke fituar dhe unë ta heq, jo, unë për një vit të ul në gradë dhe kjo bëhet vetëm në raste ekstreme.

Sa i përket pyetjes sa raste janë, unë po ju them se rastet me shkelje disiplinore të rënda numërohen me gishtat e duarve, pra janë raste ekstreme. Nëse një ushtarak aktiv do të mbajë flamurin e një partie, ndërkohë që Kushtetuta ia ndalon që të përfshihet në çështje politike, kryen një shkelje shumë të rëndë, ose nëse një ushtarak aktiv nuk respekton një urdhër të drejtpërdrejtë



të eprorit të tij, ose shkelje shumë të rëndë, vetëm në këto raste i jepet mundësi që të aplikohet ulja në gradë, por jo më shumë se një vit.

Unë mund t'ju them se shkelje shumë të rënda numërohen më gishtat e duarve, sepse pretendojmë se oficerët e Forcave tona të Armatosura kanë arsimin e duhur, që shumë rrallë kanë pasur situata që të jepen masa të rënda. Pra, janë dispozita që aplikohen rrallë, por në gjykimin tonë duhet të jenë, sepse i japin mundësi autoritetit vendimmarrës, shefit të Shtabit, ministrit, komandantit të gjykojë rrethanat vlerësuese, rënduese dhe në përputhje me to të ketë variante të ndryshme të ndëshkimit për atë që ka kryer shkelje shumë të rëndë.

**Ermonela Felaj** - Po zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Unë vazhdoj të insistoj, zonja kryetare, se kjo gjë nuk ka pse të ndodhë, aq më tepër e përcaktuar në një vit. Zotëria më parë përmendi që, nëse do të marrë dikush flamurin e një partie dhe pas një viti, pasi fitohen zgjedhjet, ky e merr sërish gradën e hequr. Grada është diçka që është e fituar dhe mund t'i hiqet vetëm me vendim gjykate. Unë jam kundër vendosjes së kësaj mase, aq më shumë që edhe vetë referuesi thotë se kjo qenka shumë e rrallë. Ka masa të tjera, të cilat shkojnë të inkuadruara shkallë pas shkalle, ndërsa me gradën, një gjë të fituar, nuk ka pse të vendoset. Ky është mendimi im.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Unë kam një pyetje: cila është diferenca ndërmjet uljes në detyrë dhe uljes së pagës me masë disiplinore?

**Ismail Shehu** – Ulja në detyrë nuk të prek gradën që ke. Pra, në Forcat e Armatosura çdo pozicion pune i korrespondon një grade të caktuar, nëse je drejtor në Shtab të Përgjithshëm, ke gradën kolonel, nëse ke gradën nënkolonel, mund të bëhesh shef sektori.

**Ermonela Felaj** - A i korrespondon një page të caktuar?

**Ismail Shehu** - Nuk i korrespondon, sepse paga është sipas gradës që mban, pavarësisht detyrës që ke. Pra, nuk ka rëndësi vendi i punës, por grada që mban. Kur themi që do të ulim në detyrë, do të thotë që mund të jesh me gradën kolonel, që të takon një pozicion drejtori, por për shkak të masës disiplinore, nuk të çoj në vendin e drejtorit, por në një vend përgjegjësi ose specialisti. Ndërsa ulja në gradë, është që për një vit nuk do të marrësh më gradën e kolonelit, por gradën e nënkolonelit, dhe kjo është një masë shumë e rëndë. Në gjykimin tonë, pas largimit nga FA-ja, kjo është masa e dytë më e rëndë. Por që, për respekt ligjshmërie, për ne nuk ka problem, sepse gradat jepen me ligj dhe po me ligj ulen një vit ose lirohesh para nga FA-ja.

Ne kemi kërkuar që të mos shkohet në çdo rast në masën ekstreme, kemi shtuar një të ndërmjetme, që është ulja në gradë. E gjykojmë të domosdoshme, është diçka që nuk vjen si propozim i vetë ministrisë, por është nga vetë ato autoritete, që kanë kompetencën e dhënies së tyre vendimeve, që të kenë edhe opsionin e uljes deri në një vit një gradë të ushtarëve të FA-së nëse kryejnë shkelje është shumë të rëndë disiplinore.

**Ermonela Felaj** – Ndjesë, unë sërish nuk e kuptova, sepse ka tri masa shumë të ngjashme dhe nuk arrij ta kuptoj kufirin e hollë mes tyre: ulja në detyrë, ulja në pagë dhe ulja në gradë. Më sillni nga një shembull të thjeshtë për këto masa disiplinore.

**Ismail Shehu** - Dakord, unë jam ushtarak aktiv, me gradën kolonel, dhe si rregull më takon të jem në pozicion drejtues, pra drejtor diku në shtab, në komandë e të tjera. Unë pagën e marr në përputhje me gradën që kam, pra, pavarësisht se çfarë detyre bëj, paga ime lidhet me gradën time, pra me të qenit kolonel. Marrim masën e parë “uljen në detyrë”, kjo nuk më prek as gradën, as pagën, është më shumë çështje prestigji. Pra, nuk shkoj më në punën e drejtorit, por më çojnë si përgjegjës sektori me gradën kolonel.

**Ermonela Felaj** - A do të ulet paga?

**Ismail Shehu** – Po, ulet paga.

Së treti, ulet paga, ulet grada, pra edhe aspekti financiar, edhe prestigji, por jo më shumë se një vit.

**Ermonela Felaj** - A ka pyetje?

**Xhemal Qefalia** - Unë mendoj se për aq kohë sa i heq mundësinë për të rimarrë pjesë në gradim, ti ia heq me të drejtë për shkeljen që ka bërë, por nuk ke pse t'i bësh edhe uljen në gradë, edhe uljen në detyrë, edhe uljen në pagë. Pra, unë mendoj ta heqim këtë “uljen në gradë” sepse është diskriminim që u bëhet gradave në ushtri. Ta rishikojmë edhe një herë, se ky është një ligj për të mbrojtur ushtarakun, jo për të pasur sensin e diskreditimit të tyre edhe në gradë.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, relatorit!

Zoti Koçi ka një ndërhyrje.

**Petro Koçi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë mendoj që dhënia e mundshme e kësaj mase disiplinore e rrit dinjitetin e gradës, nuk e ul, përkundrazi e vlerëson gradën në proporcion me performancën e ushtarakut. Nga ana tjetër, duke e futur këtë masë disiplinore, ne rrisim, po themi, opsionin që zgjidhet nga autoriteti

vendimmarrës, për të ndëshkuar një akt, një shkelje shumë të rëndë të disiplinës, kështu që mendoj se nuk është se e prek gradën.

Nga ana tjetër, grada nuk jepet me gjykatë. Janë raste të rralla kur ndërhyt gjykata për të dhënë gradën, plus dhënia e një mase disiplinore, ushtaraku mund të ankohet në gjykatë. Kështu që, nuk besoj se ne cenojmë gradën e tyre.

Pra, në fund të fundit, kur jepet masa, zgjidhet njëra, nuk bëhet vetëm që do ulet në gradë dhe patjetër do jepet edhe një masë tjetër, pra do zgjidhet njëra nga këto. Pra, do të zgjidhet njëra nga këto, gjithmonë në përpjesëtim të plotë me natyrën e shkeljeve dhe me shkallën e veprës së shkeljes së rëndë, shumë të rëndë të disiplinës. Kështu që, unë mendoj se duke rritur opsionet, kjo lidhet më mirë edhe me dinjitetin e ushtarakut, sepse sa më pak opsione të ketë, aq më i cenueshëm mund të jetë edhe dinjiteti i ushtarakut, ndërsa kështu, ne respektojmë edhe dinjitetin e disiplinës edhe dinjitetin e ushtarakut dhe të gradës së tij.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Relatori.

**Xhemal Qefalia** - Me gjithë respektin e madh që kam për zotin Koçi, mendoj që këtu gabohet shumë, zoti Petro, pasi e njej shumë pak këtë fushë dhe fakti që thatë që, gradën nuk e jepet gjykata, nuk tha njeri që gradën e jep gjykata. Grada fitohet, jepet nga një komision, plotëson të gjitha kriteret dhe merret dhe nuk mund ta heqë asnjë komision tjetër disiplinor, por një gradë e fituar nuk mund të hiqet, zoti Petro, ashtu siç nuk hiqet një gradë shkencore. Është një gjë që është fituar, nuk është një gjë që ti ia ke dhënë, ia ke falur dhe ia merr, prandaj kjo duhet marrë në konsideratë. Nuk mund t'i heqësh t'i një doktori të shkencave gradën, se bëri një gabim apo një mjeku që ka gradën “doktor” dhe i heq gradën, nuk mundesh, ajo është një gradë e fituar. Ti mund ta nxjerrësh në lirim për shkelje, mund ta heqësh nga Forcat e Armatosura, mund ta çosh përpara drejtësisë, mund ta dënosh, por gradën nuk ia heq dot, zoti Petro. Je shumë gabim te kjo pjesë, ndoshta ndikon edhe *background-i* që keni, si civil. Kjo nuk është një gjë që ndikon te Forcat e Armatosura, për rritjen e disiplinës. Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Qefalia!

Zoti Shehu e kërkon fjalën.

**Ismail Shehu** – Vërtet është legjislacion tjetër, por Kodi Penal Ushtarak e njej uljen në gradë, pra kjo dispozitë nuk është risi, që mbiu nga qielli, por është diçka që ekziston në kuadrin

ligjor rregullues. Pra, është për vepra penale, ne sugjerojmë të futet edhe për shkelje disiplinore shumë të rënda. Kur flasim për diskriminim apo cenim, duhet të kemi kujdes, sepse nuk po flasim për ushtarakë të pafajshëm, që një ditë të bukur u zgjua dikush, shefi i shtabit të ministrit dhe tha “hajde po ia ul gradën”. E para, s’po ia heqim, por po ia ulim përkohësisht.

E dyta, po flasim për njerëz që janë hetuar nga një komision disiplinor dhe kanë kryer shkelje të tipit; kanë konsumuar apo janë konsumatorë të rregullt të lëndëve narkotike, organizojnë lojëra fati, kryejnë ngacmime seksuale ndaj vartësve të tyre, organizojnë dhe marrin pjesë nëpërmjet fushat elektorale, pra po flasim për një ushtarak ndaj të cilit është provuar katërcipërisht me një procedurë *quasi* gjyqësore, me komisione, me të gjitha, që ka kryer një shkelje ekstreme, për këtë kategori po flasim, nuk po flasim që po i biem në qafë një oficeri dhe po i heqim gradën. Dhe nuk është e vërtetë, se nuk është heqje, është ulje përkohësisht, deri në një vit, por keni parasysh që po flasim për atë kategori që kryen një shkelje shumë ekstreme dhe po të doni mund t’i lexojmë një nga një. Të jeni të bindur, që secila nga këto shkelje shkon deri në lirim nga Forcat e Armatosura, që është edhe më e rëndë. Kështu që, për mua bën sens dhe i jep mundësi autoritetit që të ketë disa alternativa në vendimmarrje.

**Xhemal Qefalia** – Zotëri, kush po ju thotë që nuk është shkelje...*(Nuk dëgjohet)*, nuk është vetëm shkelja aty, është non sens. E kuptoni që po elaboroni gjëra të paqena? Shkeljet disiplinore janë të përshkallëzuara, kemi shkelje, por nuk po them që ky duhet të marrë dekoratë, por jo t’i heqësh gradën, o zotëri. Kush je ti që mund t’i heqësh gradën, një gradë që ai e ka fituar? Kush jeni ju?

**Petro Koçi** – Ia heq ligji. Për të mos e përjashtuar fare i jepet kjo mundësi.

**Ermonela Felaj** – Kolegë, qartësisht ne patëm diskutim edhe për nenin më parë të shkeljeve shumë të rënda, patëm diskutim për masat që jepen në rastin e këtyre shkeljeve. Meqenëse e lamë të hapur diskutimin, për t’u qartësuar të gjithë me legjislacionin, ju sugjeroj se do të ishte më e udhës që, edhe diskutimin për këtë nen ta lëmë të hapur, deri në mbledhjen tjetër, kur të kemi krijuar një qëndrim të qartë, në raport me atë se çfarë duhet të sanksionojmë, nëpërmjet ndryshimeve që propozohen.

Besoj se kjo është më e udhës, sepse opinionet, qoftë të relatorit, qoftë të propozuesit të projektligjit, ne i dëgjuam, por është nevojshme që të gjithë kolegët të krijojnë një qëndrim të qartë në lidhje me këtë çështje.

Atëherë, kalojmë te neni 8 i projektligjit, i cili bën një ndërhyrje në nenin 18 të ligjit aktual “Rrethanat lehtësues”. Kuptohet, që në rastin e kryerjes së shkeljeve mund të ketë edhe rrethana të natyrës lehtësuese të dhënies së masës disiplinore dhe në këtë rast, propozimi përkatës bëhet nëpërmjet këtij neni. Nga relatori kemi ndonjë sugjerim në lidhje me këtë nen?

**Xhemal Qefalia** - Jam dakord.

**Ermonela Felaj** – Po. Faleminderit!

Nga kolegët e tjerë, keni vërejtje apo sugjerime?

Atëherë, unë ju ftoj të shikoni që ky nen është i lidhur ngushtë me nenin paraardhës, kështu që, në rast se nuk vendosim për përmbajtën e nenit paraardhës, nuk e kemi sesi të vendosim për nenin 8. Kështu që, eventualisht nenin 8 do e lëmë të hapur që do të shkojë konform nenit 7.

Kalojmë te neni 9, që ndryshon nenin 19 të ligjit aktual “Rrethanat rënduese”. Edhe në këtë rast shohim që bëhet një listë pothuajse e gjatë e të gjitha atyre që konsiderohen si rrethana rënduese dhe natyrisht, ndodhja e rrethanave rënduese, automatikisht rëndon edhe masën disiplinore. Edhe për këtë nen, për të njëjtën arsye, unë gjykoj ta lëmë të hapur, në varësi të nenin 8.

Kalojmë te neni 10, që bën fjalë për rehabilitimin. Ky është neni 23 i ligjit aktual. Ndryshim është shumë i thjeshtë në fakt, në fjalinë e fundit të shkronjave “a” dhe “b” të nenit aktual të ligjit shtohet shprehja “me urdhër të autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore”. Pra, po jua lexoj fjalinë: “Ushtarakët e Forcave të Armatosura ndaj të cilëve është marrë një masë e lehtë disiplinore, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji dhe që për një periudhë 6- mujore nuk kanë kryer asnjë shkelje tjetër disiplinore, në përfundim të kësaj periudhe masa disiplinore u hiqet nga dosja personale e ushtarakut me urdhër të autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore”. Ky është ndryshimi që bëhet, pra nuk vjen automatikisht fshirja, por kërkohet edhe veprimi i një autoriteti, siç është autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore, i cili konstaton periudhën përkatëse që ka përfunduar dhe në përfundim të asaj periudhe, natyrisht personi konsiderohet i rehabilituar nga masa. Kjo është ideja e këtij neni. Keni vërejtje apo sugjerime për këtë nen?

Mirë, ju ftoj ta votojmë. Kush është dakord me nenin 10 të projektit? Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11 i projektit, i cili bën fjalë për një ndërhyrje në nenin 25 të ligjit aktual “Ankimi për masat disiplinore”. Ndryshimi i propozuar e shndërron pikën 4 të nenin 25 të ligjit aktual në këtë trajtë, pika 1: “Ankimi për masat e lehta disiplinore të dhëna nga komandantët në nivel toge, kompanie ose batalioni, bëhet tek eprori i drejtpërdrejtë i autoritetit përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore”.

2. “Për masat e lehta disiplinore, të dhëna nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nga komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse, si dhe ato të strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nuk lejohet ankimi”.

3. “Ankimi për masat e rënda disiplinore, të dhëna nga komandantët në nivel batalioni, bëhet te komandanti i forcës apo strukturës mbështetëse përkatëse”.

Vijmë te pika 4 dhe kjo është pika ku bëhet ndryshimi: “Ankimi për masat e rënda disiplinore, dhe shumë të rënda”, (pra kjo është shtesa “shumë të rënda“, sepse thamë kemi kategorizim 3 fasha), të dhëna nga komandantët e forcave dhe strukturave mbështetëse apo strukturave të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, bëhet te Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”.

Pastaj vjen pika 5: “Ankimi për masat e rënda dhe shumë të rënda disiplinore, të dhëna nga Shefi i Shtabit bëhet drejtpërdrejt në gjykatë”, kjo kuptohet, sepse është ezauruar niveli administrativ më i lartë, që është Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe pastaj kalohet në Gjykatën Administrative.

Besoj që ndërhyrja është qartë dhe i shkon logjikës në të cilën janë ndërtuar ndryshimet e propozuara në këtë projekt.

Kush është dakord me nenin 11 të projektit? Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet edhe ky nen.

Neni 12 ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit që është në afatin e zakonshem. Besoje nuk keni kontestime për këtë nen. Kush është dakord me nenin 12? Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Ndërkohë, ne lamë të hapur disa nene. I ftoj kolegët që në mbledhjen më të parë, që sigurisht do të jetë në fillim të javës që vjen, meqenëse ky ligj së bashku me projektligjin tjetër “Për karrierën në Forcat e Armatosura”, do të jenë në seancën plenare të javës së ardhme, të mbyllim diskutimin për 3 nenet që lamë të hapur, duke kërkuar që të kemi konsensus midis grupit

të punës nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe relatorit tonë, por edhe nëse ka nevojë për kolegë të tjerë që mund t'i vijë në ndihmë zotit Qefalia, besoj se do të kemi më shumë se një koleg që do shprehë gatishmëri, në mënyrë që të mund ta mbyllim edhe votimin në tërësi të këtij projekti.

Po, zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të risqaroj dhe një herë, dy gjëra.

E para, projektligji është shqyrtuar dhe konsultuar me ushtarakët më të mirë që kanë sot Forcat tona të Armatosura, pra nuk është një projektligj, po them, që është bërë në zyrat e ministrisë nga civilët, pavarësisht se civilët janë të përfshirë në procesin e hartimi të projektligjeve, siç është rasti i zotit Shehu, i cili është përgjegjës direkt për këtë proces, por përgjithësisht, gjithçka është propozuar nga vetë ushtarakët. Nga kjo pikëpamje, s'ka nevojë për asnjë lloj pikëpyetje.

E dyta, projektligji ka respektuar standardet e mirëfillta dhe të qarta ndërkombëtare, pra të vendeve të NATO-s dhe natyrisht me model kryesor atë të mënyrës sesi funksion ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Besoj se kjo duhet pasur parasysh edhe në shqyrtimin e mëtejshëm të atyre neneve që u lanë *pending*, për t'u parë në fillim të javës që vjen. Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit!

Në fakt, dua t'ju them edhe në emër të komisionit, që ne nuk e kemi vënë në dyshim faktin që ju keni punuar fort me strukturat tuaja, shumë seriozisht, për këtë projekt dhe për projektin tjetër që ne diskutuam së bashku, por problemi para të cilit u ndodhëm, më shumë sesa një problem që lidhet me çështje të sigurisë kombëtare, është një problem i ligjit, është një problem juridik, që ndoshta jo të gjithë ne e kemi kompetencën e duhur, profesionale për t'i dhënë drejtim.

Kështu që, gjykoj se është më e përshtatshme edhe në nderin e punës së këtij komisioni, por edhe në nderin tuaj si përfaqësues të institucionit të lartë të ekzekutivit, që ne t'i japim pak kohë vetes, për ta riparë edhe një herë, qoftë edhe formulimin, dhe për të qenë të sigurt, për atë çka jemi duke vendosur në përmbajtje të projektit të ri, që ndryshon ligjin "Për disiplinën në Forcat e Armatosura". Besoj se kjo është më oportune për të gjithë ne. Nuk kemi ndonjë ngut. Kemi të gjithë kohën e nevojshme në dispozicion, që ta marrim pak më me qetësi diskutimin e neneve për të cilat folëm.

Kolegë, ju faleminderit të gjithëve për ndërhyrjen dhe për kontributin!

Ne e mbyllim këtu këtë pikë të parë të rendit të ditës.

Unë dua të ftoj zotin Jenisleri, për të bërë prezantimin e një nisme që ai ka përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë, për të cilën ne jemi komisioni përgjegjës dhe Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi. Kështu që, me gjasë, sot do të bëjmë prezantimin e ligjit dhe pastaj do të shikojmë sesi do të operojmë.

Do bëjmë 10 minuta pushim edhe për sistemin, kështu që në orën 11:30 do të rifutemi në sistem.

Faleminderit!